



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 76**

**5 korrik**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i METE nr. 4, datë 14.6.2012	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar .....	3525
Udhëzim i MPPT nr. 7, datë 15.6.2012	Për kontrollin e mjeteve të transportit në regjim të temperaturave të kontrolluara sipas marrëveshjes ATP .....	3529
Udhëzim i MB nr. 102, datë 13.6. 2012	Për mënyrën e evidentimit në mungesë të kundërvajtjeve administrative, në fushën e qarkullimit rrugor .....	3545
Udhëzim i MB nr. 106, datë 19.6.2012	Për kontrollin e zbatimit të rregullave nga subjektet që kryejnë veprimtarinë për mbledhjen, depozitimin dhe shkatërrimin e mjeteve ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura” .....	3548

**UDHËZIM**  
**Nr. 4, datë 14.6.2012**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 529, DATË 8.6.2011  
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS DHE TË MËNYRËS SË  
DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË  
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të kapitullit IX të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

**UDHËZON:**

1. Procedurat e konkurrimit për dhënien me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore kryhen prej organit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës.

2. Në zbatim të pikës 2 dhe pikës 5 “b” të kreut I të vendimit, dhënia me qira e makinerive e pajisjeve, në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave, bëhet nga njësia që ka në administrim objektin e kontratës së qirasë, e cila përcakton vlerën e qirasë mujore për çdo vit, sipas përcaktimeve në pikën 3 të kreut III “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, të këtij vendimi.

3. Në zbatim të pikës 5 “c” të kreut I të vendimit, institucioni që ka në administrim objektet e dhëna me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj., dhe asetet që kërkohen me qira në ndihmë të aktivitetit të lejes përkatëse, plotëson dokumentacionin për dhënien me qira të aseteve, sipas pikës 1 të kreut II të vendimit të cituar dhe e përcjell në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së bashku me projektkontratën. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shqyrton dokumentacionin dhe autorizon në emër dhe për llogari të saj, së bashku me projektkontratën, institucionin që monitoron lejen e shfrytëzimit, për të lidhur kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për periudhë jo më të gjatë se afati i lejes së dhënë. Në kontratën e qirasë nuk përfshihet sipërfaqja e dhënë me leje shfrytëzimi, por sipërfaqet dhe objektet në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar.

4. Në zbatim të pikës 5 “ç” të kreut I të vendimit, subjekti paraqet në METE kërkesën për kontratë huapërdorje për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave, të konfirmuar në biznesplanin e paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit, të shoqëruar me dokumentacionin, si vijon:

- lejen për ndërtimin e fabrikës, të lëshuar nga organi që e ka në kompetencë;
- genplanin e sipërfaqes ku do të ndërtohet fabrika, të përgatitur sipas pikës 1 “ç” të kreut II të vendimit;

- kopje të noterizuara të lejes së shfrytëzimit, marrëveshjes minerare dhe biznesplanit.

5. Në zbatim të pikës 5 “d” të kreut I, zgjatja e marrëdhënieve kontraktore për kontratat e qirasë, të lidhura pa konkurrim dhe për objekte me sipërfaqe të përgjithshme mbi 500 m<sup>2</sup>, bëhet me kushtin që afati në total i kontratës, nuk duhet të kalojë afatet e përcaktuara në pikën 6 të kreut I të vendimit të cituar. Zgjatja e marrëdhënieve kontraktore bëhet me kërkesë të subjektit qiramarrës. Njësia që ka në administrim objektin përgatit genplanin e tij sipas pikës 1 “ç” të kreut II të vendimit dhe e dërgon në organin që ka lidhur kontratën e qirasë. Për afatin e ri, vlera e detyrimit mujor të qirasë do të aplikohet referuar tarifave dysheme të përcaktuara në kreun II të vendimit të cituar, duke përfutur edhe përqindjen e uljes për treguesin e investimit, në rastet kur subjekti e ka përfutur këtë të drejtë.



6. Në zbatim të pikës 5 “dh” të kreut I, për dhënien me qira të objekteve shtetërore për institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare apo ish-ndërmarrjet, kontratat lidhen nga institucioni, shoqëria apo ish-ndërmarrja që i administron ato, me afat jo më shumë se 5 vjet. Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë përgatitet sipas pikës 1 të kreut II të vendimit dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysHEME të përcaktuara në kreun II të vendimit të cituar.

7. Në zbatim të pikës 5 “e” të kreut I, shtesat në kontratë bëhen me qëllim përmirësimin ose shtimin e veprimtarisë së parashikuar në kontratë, dhe shtesa është sipërfaqe funksionale në kufi me objektin e kontratës së qirasë.

Subjekti qiramarrës, që ka të lidhur një kontratë me sipërfaqe trualli mbi 500 m<sup>2</sup>, paraqet një kërkesë të argumentuar pranë institucionit që ka lidhur kontratën, i cili pasi e shqyrton, i kërkon njësisë që ka në administrim objektin, të përgatisë genplanin e përgjithshëm (sipërfaqja totale sipas kontratës së qirasë dhe sipërfaqja që kërkohet të shtohet), sipas përcaktimeve në pikën 1 “ç” të kreut II të vendimit dhe brenda 30 ditëve të dërgojë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ose në organin që ka lidhur kontratën. Nëse njësisia që ka në administrim objektin brenda këtij afati nuk kthen përgjigje, organi që ka lidhur kontratën emëron ekspertë për hartimin e genplanit dhe e dërgon për verifikim në prefekturën përkatëse. Shpenzimet financiare për ekspertët e emëruar i përballon shoqëria qiramarrëse.

8. Në zbatim të pikës 8 të kreut I, për kontratat me afat mbi 1 vit, vlera dysHEME e detyrimit mujor të qirasë do të llogaritet duke aplikuar tarifat e përcaktuara në kreun III të vendimit të cituar.

9. Në zbatim të pikës 1 “c” të kreut III, me termin “truall të lirë” do të kuptohen rastet kur sipërfaqja është shesh i lirë dhe nuk është pjesë funksionale e ndonjë objekti ndërtimor.

10. Në zbatim të pikave të kapitullit IV “Nxitja e biznesit”, për përfitimin e zbritjes së detyrimit mujor të qirasë, qiramarrësi ose enfiteozmarrësi i paraqet qiradhënësit kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) vërtetim për punësimin mesatar vjetor të realizuar në vitin përkatës, të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse;

b) raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilancet financiare të asaj shoqërie;

c) bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për vitin përkatës.

Zbritja e detyrimit mujor për nivelin e punësimit të realizuar mbrohet çdo vit nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, me dokumentacionin përkatës, ndërsa zbritja e detyrimit mujor për nivelin e investimit të realizuar vlen deri në përfundim të kontratës. Kur niveli i punësimit ndryshon nga viti paraardhës dhe përfshihet në grup tjetër, miratohet koeficienti zbritës i ri, sipas akteve ligjore në fuqi në atë moment.

11. Në zbatim të pikës 1 të kapitullit IV të vendimit, procedohet si vijon:

Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit, pasi shqyrton propozimet e përgatitura sipas pikës 1 në kapitullin II të këtij vendimi, i propozon Këshillit të Ministrave për rastet kur është me interes të aplikohet kontrata me tarifën 1 euro kontrata, për ushtrim të aktivitetit prodhues. Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për kontratë me tarifën 1 euro kontrata, organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit fillon procedurat sipas pikave të tjera në kapitullin II të vendimit të cituar dhe kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave e mësipërme.

12. Në zbatim të pikës 5, 6 dhe 7 të kreut V të vendimit, koncesionarët në fushën e ndërtimit të burimeve të reja energjetike, në funksion të ushtrimit të aktivitetit të autorizuar, kanë të drejtën e lidhjes së kontratave me tarifën simbolike 1 euro kontrata, për përdorim të pasurive të paluajtshme. Procedurat deri në lidhjen e këtyre kontratave ndiqen nga Drejtoria e Standardeve Elektroenergjetike, pranë METE-s.

13. Koncesionarët në fushën e ndërtimit të burimeve të reja energjetike, në funksion të ushtrimit të aktivitetit të autorizuar, kërkojnë dhënien në përdorim, me tarifën simbolike 1 euro kontrata, prona të paluajtshme të shtetit, pranë entit publik apo njësisë së pushtetit vendor, që ka në pronësi pronën publike. Kërkesa duhet të përmbajë dokumentacionin si vijon:

a) kërkesën për marrjen në përdorim të pasurisë së paluajtshme me tarifën simbolike 1 euro kontrata dhe qëllimin e përdorimit të saj;

b) kopje të kontratës së koncesionit të lidhur me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

c) përshkrimin e pasurisë që kërkohet dhe të dhëna për vendndodhjen e saj, të shoqëruar me vërtetime, certifikata apo të dhëna të tjera, që mund të disponojë kërkuesi mbi regjistrimin e pronës në ZRPP-në vendore;

d) planin e investimeve të parashikuar për t'u aplikuar në pasurinë përkatëse dhe fazat për zhvillimin e tij;

e) kopje të pagesës së garancisë së kontratës së koncesionit.

14. Në rast se brenda 30 ditësh, nga marrja e dokumentacionit, enti publik apo njësia e pushtetit vendor që ka në pronësi pronën publike që kërkohet në përdorim me tarifën simbolike 1 euro kontrata, nuk kanë lidhur kontratën respektive me koncesionarin, atëherë do të konsiderohet se është refuzuar dhënia në përdorim të pronës publike. Në këto kushte koncesionari apo subjekti i autorizuar i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila fillon menjëherë procedurat për ndryshimin e të drejtës së administrimit dhe pronësisë për pronën e paluajtshme përkatëse, sipas përcaktimeve në pikën 6 të kreut V të vendimit.

15. Për pronat e paluajtshme që shtrihen në zonat që preken nga ndërtimi i burimeve të reja energjetike, për të cilat nuk është regjistruar titulli i pronësisë apo rezultojnë pa pronarë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas kërkesës së koncesionarit apo subjektit të autorizuar, kryen menjëherë regjistrimin dhe inventarizimin e këtyre pronave si prona të paluajtshme të shtetit, pranë Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Me përfundimin e këtij procesi, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës fton koncesionarin apo subjektin e autorizuar për lidhjen e kontratës për dhënien në përdorim të këtyre pronave me tarifën simbolike 1 euro kontrata, për gjithë kohëzgjatjen e koncesionit apo periudhës së autorizuar.

16. Në rastin e pyjeve, kullotave apo pasurive të tjera të paluajtshme, që kanë regjim të veçantë për nxjerrjen nga fondi përkatës, do të ndiqen procedurat e përcaktuara nga ligjet e posaçme për ndryshimin e qëllimit të përdorimit të këtyre pasurive dhe, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, do të kryhet kalimi i përgjegjësisë së administrimit në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

17. Të gjitha kostot dhe shpenzimet për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit apo revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, do t'i ngarkohen koncesionarit apo subjektit të autorizuar që lidh kontratën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në zbatim të pikave 3 dhe 4 të kreut V të vendimit, kontratat me tarifën simbolike 1 euro që lidhen për dhënien në përdorim të pronave të paluajtshme të shtetit për subjektet koncesionare në fushën e ndërtimit të burimeve të reja energjetike, në funksion të ushtrimit të aktivitetit të autorizuar, si garanci kontrate do të shërbejë garancia e kontratës së koncesionit.

19. Në zbatim të pikës 2 "c" të kapitullit VI të vendimit, njësitë monitoruese të kontratave të qirasë, enfiteozës ose kontratave me tarifën simbolike 1 euro kontrata:

- monitorojnë në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratës:



- ndjekin për çdo muaj, që subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarëse të derdhin në afatin e përcaktuar në kontratë detyrimin mujor të qirasë;
- bëjnë përlllogaritjen e kamatëvonesave dhe ndjekin derdhjen e tyre sipas rregullave financiare;
- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për investimet që kryhen në objektin e marrë me qira ose enfiteozë;
- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira ose enfiteozë;
- zgjidhin problemet që lindin gjatë kohës që është në fuqi kontrata, për të cilat është përgjegjëse njësia që ka në administrim objektin;
- hartojnë çdo 6 muaj akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për realizimin e kushteve të kontratës: derdhjen e detyrimeve mujore dhe kamatëvonesave, punësimin e realizuar në objektin e marrë me qira dhe investimet që kryen subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrës dhe një kopje e përcjellin në institucionin që ka firmosur kontratën e qirasë.

20. Në zbatim të kreut VI “Monitorimi i kontratave”, detyrat e monitorimit të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, ushtrohen për të gjitha format e kontratave të lidhura sipas këtij vendimi.

21. Në zbatim të pikës 7 të kreut VI “Monitorimi i kontratave”, genplanet e ndryshuara përgatiten nga njësia që ka në administrim objektet e dhëna me qira dhe ndryshimi i tyre në kontratë, bëhet me aneks kontrate, pa ndryshuar asnjë nga termat e kontratës, që nuk lidhen me sipërfaqen e marrë me qira.

22. Në zbatim të pikës 1 në kreun VIII “Vlefshmëria e kontratave”, kur ndërmarria, shoqëria apo institucioni shitet para përfundimit të kontratës, në publikimin për shitje do të njoftohet ekzistenca e kontratave të qirasë ose enfiteozës, ku sipërfaqja e truallit mbi të cilin shtrihet objekti i marrë me qira (sipërfaqja nën objekt plus sipërfaqen funksionale), është mbi 500 m<sup>2</sup>. Në dosjen përkatëse të shitjes duhet të ketë një kopje të kontratës.

23. Në zbatim të pikës 4 të kreut VIII “Vlefshmëria e kontratave”, e drejta e privatizimit të drejtpërdrejtë u lind subjekteve kontraktuese në rastet kur sipërfaqja e truallit (sipërfaqja nën objekt plus sipërfaqen funksionale) mbi të cilin shtrihet pasuria, objekt i kontratës, është mbi 500 m<sup>2</sup>. Me kërkesë të subjektit qiramarrës ose enfiteozëmarrës, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron ngritjen e grupit për vlerësimin e investimeve të kryera në objektin e kontratës. Kështu procedohet edhe për kontratat e lidhura nga organet e pushtetit vendor, kur këto të fundit ushtrojnë të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të dhënë me qira. Ministri përgjegjës për ekonominë, urdhëron ngritjen e grupit të ekspertëve për vlerësim të investimeve, me propozim të organit që ka lidhur kontratën, të shoqëruar me kopje të kontratës dhe genplanit të objektit të kontratës.

24. Në zbatim të paragrafit të fundit në pikën 4 të kreut VIII “Vlefshmëria e kontratave”, pagesa e ekspertëve të miratuar, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert, urdhërohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pasi miraton raportin e tyre.

25. Udhëzimi nr. 906, datë 21.11.2011 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyjn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
Nasip Naço

## UDHËZIM

Nr. 7, datë 15.6.2012

### **PËR KONTROLLIN E MJETEVE TË TRANSPORTIT NË REGJIM TË TEMPERATURAVE TË KONTROLLUARA SIPAS MARRËVESHJES ATP**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 9289, datë 7.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen “Për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mjetet e veçanta, që përdoren në këto transporte”, nenit 50 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

#### KAPITULLI I

##### 1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

###### 1.1 Ky udhëzim ka për qëllim:

a) përcaktimin e procedurave për kryerjen e kontrollit në mjetet e transportit të mallrave në regjim temperature të kontrolluar në zbatim të marrëveshjes “Mbi transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mjetet e veçanta, që përdoren në këto transporte (ATP)”, në të cilën Shqipëria ka aderuar më 26 janar 2005 me ligjin nr. 9289, datë 7.10.2004;

b) kontrollin e karakteristikave izotermike të mjeteve të transportit në regjim temperature të kontrolluar sipas seksionit 5 dhe 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes ATP, nga ekspertët e emëruar sipas këtij udhëzimi, si dhe njohjen e kontrolleve të kryera nga ekspertët e emëruar nga autoritetet kompetente të shteteve palë kontraktuese të marrëveshjes ATP;

c) përcaktimin e procedurave për emërimin e ekspertëve dhe miratimin e kushteve që duhet të përmbushë ambienti i kryerjes së provave.

1.2 Ky udhëzim zbatohet për të gjitha mjetet e transportit me karroceri izotermike me ose pa grup frigorifer/kalorifer të regjistruar në Shqipëri:

a) që kryejnë transportin ndërkombëtar rrugor që përshkojnë territore shtetesh, palë kontraktuese të marrëveshjes ATP, si për të tretë dhe me qira, dhe për ato për llogari të vet shoqërisë, nëse pika në të cilën ushqimet apo pajisja që i mban ato, janë ngarkuar mbi një mjet rrugor, dhe pika në të cilën ato janë ngarkuar ose shkarkuar është e vendosur në territorin e Shqipërisë;

b) për transport rrugor për të tretë dhe me qira, si dhe për llogari të vet, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

##### 2. Përkufizime dhe standardet e mjeteve transportuese

Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, më poshtë po japim disa përkufizime të nevojshme, si:

“ATP” nënkupton marrëveshjen për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mjetet e veçanta, që përdoren për këtë transport;

“Autoritet kompetent” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), me kompetencë për procesin e certifikimit, për lëshimin dhe, sipas rastit, tërheqjen e certifikatave të miratimit ATP, dhe për të vepruar si pikë kontakti për autoritetet e miratimit të shteteve anëtare të tjera të marrëveshjes, dhe për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të caktuara në zbatim të këtij udhëzimi;

“Ambient prove” është subjekti i miratuar nga autoriteti kompetent për të kryer provat ose si një subjekt vlerësimi i përputhshmërisë për të kryer vlerësimin fillestar dhe teste apo inspektime të tjera, në emër të autoritetit kompetent, nëse për vetë autoritetin kompetent është e mundur të përmbushë këto funksione;



“Certifikatë ATP” nënkupton dokumentin nëpërmjet të cilit autoriteti kompetent certifikon zyrtarisht që miratohet një pajisje izotermike, ngrirëse, frigoriferike ose kaloriferike për transport kombëtar dhe ndërkombëtar rrugor të ushqimeve delikate, në përputhje me standardet e marrëveshjes ATP;

“Çdo referencë në këtë udhëzim si “marrëveshje”, “aneks”, “shtojcë”, “seksion”, “paragraf” do të interpretohen në lidhje me transportin e ushqimeve delikate dhe pajisjet e veçanta të transportit me rrugë, si referencë “marrëveshje”, “aneks”, “shtojcë”, “seksion” ose “paragraf” të marrëveshjes ATP;

“Mjetet e transportit ose pajisjet transportuese” nënkupton kamionët, rimorkiot, gjysmërimorkiot, kontejnerët, cisternat ose pajisjet e tjera të izoluar për kryerjen e transportit rrugor të ushqimeve delikate sipas përcaktimeve të marrëveshjes;

“Mjet transportues izotermik” është mjete, trupit (në rastin e cisternave trupit është vetë cisterna) i të cilit është i ndërtuar me mure, dyer, dysheme dhe tavan të izoluar, ku shkëmbimi i nxehtësisë ndërmjet pjesës së brendshme dhe të jashtme të trupit është i kufizuar në masën që koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë (k), është i tillë që mjete bën pjesë në një prej dy kategorive të mëposhtme:

$I_N$  = Mjet transportues i izoluar normal: i karakterizuar nga një koeficient  $k \leq 0.70$   $W/m^2 \cdot K$

$I_R$  = Mjet transportues i izoluar së tepërmi: i karakterizuar nga një koeficient  $k \leq 0.40$   $W/m^2 \cdot K$  dhe me mure me një trashësi të paktën 45 mm për mjetin transportues me një gjerësi më të madhe se 2.50 m.

Përcaktimi i koeficientit K dhe metoda e përdorur për matjen e tij jepen në shtojcën 2, aneksi 1 të marrëveshjes.

“Mjet transportues i ftohtë” është pajisja e izoluar, e cila, duke përdorur një burim të ftohtë (akull natyror, me ose pa kripë shtesë; pllaka eutetike, akull të thatë, me ose pa kontrollin e sublimitimit; gaze të lëngëta, me ose pa kontrollin e avullimit etj.), përveç njësisë mekanike ose “absorbuese”, është në gjendje që me një temperaturë të jashtme  $+30^\circ C$ , të ulë temperaturën brenda trupit bosh, dhe pastaj ta ruajë atë:

Në  $+7^\circ C$ , maksimumi në rastin e klasit A;

Në  $-10^\circ C$ , maksimumi në rastin e klasit B;

Në  $-20^\circ C$ , maksimumi në rastin e klasit C;

Në  $0^\circ C$ , maksimumi në rastin e klasit D;

Në qoftë se pajisje të tilla përfshijnë një ose më shumë ndarje, kontejnerë apo depozita për ftohësit, ndarjet e përmendura, kontejnerët apo depozitat duhet të jenë në gjendje të mbushen apo rimbushen nga jashtë, si dhe të kenë një kapacitet në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.1.3, shtojcës 2, aneksi 1.

Koeficienti K i njësisë së klasave B dhe C duhet në çdo rast të jetë i barabartë ose më i vogël se  $0.40 W/m^2 \cdot K$ .

“Mjet transportues frigoriferik” është mjete transportues i izoluar i pajisur me ftohësin e vet ose e shoqëruar bashkë me njësitë e tjera të pajisjes transportuese, të cilat duhet të jenë në gjendje pune (pajisur ose me kompresor mekanik, ose me njësi “thithëse” etj.). Pajisja duhet të mundësojë, me një temperaturë të jashtme prej  $+30^\circ C$  të ulë temperaturën  $T_i$  brenda trupit bosh dhe më pas ta ruajë atë në një temperaturë si më poshtë:

Klasi A. Mjete frigoriferik në mënyrë mekanike i shoqëruar me një pajisje ftohëse të tillë që të mbajë  $T_i$  midis  $+12^\circ C$  dhe  $0^\circ C$ .

Klasi B. Mjete frigoriferik në mënyrë mekanike i shoqëruar me pajisje ftohëse të tillë që të mbajë  $T_i$  midis  $-10^\circ C$  dhe  $+12^\circ C$ .

Klasi C. Mjeti frigoriferik në mënyrë mekanike i shoqëruar me pajisje ftohëse të tillë që të mbajë Ti midis  $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$  dhe  $+12\text{ }^{\circ}\text{C}$ .

Klasi D. Mjeti frigoriferik në mënyrë mekanike i shoqëruar me një pajisje ftohëse të tillë që të mbajë Ti të barabartë ose më të vogël se  $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ .

Klasi E. Mjeti frigoriferik në mënyrë mekanike me një pajisje të tillë që Ti më i vogël ose baras me  $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$ .

Klasi F. Mjeti frigoriferik në mënyrë mekanike me ftohje të tillë që  $Ti \leq -20^{\circ}\text{C}$ . Koeficienti K i pajisjes për klasat B, C, E dhe F duhet që në çdo rast të jetë më i vogël ose baras  $0.40\text{ W/m}^2\text{ K}$ .

Mjet transportues kaloriferik është mjeti transportues izolues, i cili është në gjendje të rrisë temperaturën brenda trupit bosh dhe më pas të ruajë atë temperaturë për një periudhë jo më pak se 12 orë pa përsëritjen e furnizimit, në një vlerë konstante jo më pak se  $+12^{\circ}\text{C}$  kur temperatura jashtë ambientit të trupit është e treguar më poshtë për dy nga klasat:

- a)  $-10^{\circ}\text{C}$  në rastin e pajisjes ngrohëse të klasit A;
- b)  $-20^{\circ}\text{C}$  në rastin e pajisjes ngrohëse të klasit B.

Pajisjet kaloriferike duhet të kenë kapacitetin konform dispozitave të paragrafëve 3.3.1 deri 3.3.5 të shtojcës 2 të aneksit 1.

Koeficienti K i pajisjes së klasës B, duhet që në çdo rast të jetë më i vogël ose baras me  $0.40\text{ W/m}^2\text{ K}$ .

3. Mjetet transportuese të ushqimeve delikate në transportin ndërkombëtar specifikohen si mjete transporti “izotermike”, “të ftohtë”, “frigoriferike” ose “kaloriferike”, kur ato plotësojnë përcaktimet dhe standardet e vendosura në aneksin 1 të marrëveshjes ATP.

#### 4. Kushtet gjatë transportimit

4.1 Mjetet e transportit të ushqimeve të listuara në anekset 2 dhe 3 të marrëveshjes, duhet të sigurojnë që gjatë transportit temperatura më e lartë e ushqimeve në çdo pikë të ngarkimit të mos e kalojë temperaturën e treguar në paragrafët 4 të aneksit 2 dhe 3 të marrëveshjes.

Mjetet e transportit që përdoren për transportin e këtyre ushqimeve duhet të jenë të pajisur me një instrument matës të temperaturës referuar shtojcës 1, aneksi 2.

4.2 Plotësimi i kërkesave të pikës 4.1 të këtij udhëzimi duhet t’i kërkohej transportuesit të marrë me qira vetëm nëse ata kanë marrë përsipër që të sigurojnë plotësimin e këtyre kushteve, dhe nëse ky plotësim varet nga kryerja e këtyre shërbimeve.

4.3 Gjatë transportit, i cili është subjekt i dispozitave të marrëveshjes ATP dhe për të cilin pika e ngarkimit është në territorin e një shteti palë kontraktuese e kësaj marrëveshjeje, përgjegjësia për plotësimin e kërkesave të pikës 4.1 të këtij udhëzimi, do të jetë:

a) në rast të transportit për të tretë ose me qira, me personin qoftë individ ose bashkëpronësi, i cili është dërguesi i ngarkesës sipas dokumenteve të transportit ose, në mungesë të një dokumenti transporti, me personin, qoftë individ apo bashkëpronësi, i cili është në kontratën e transportit me transportuesin;

b) në rastet e tjera me personin, qoftë individ ose shoqëri që kryen transportin.

5. Dispozitat në lidhje me kontrollin e mjeteve transportuese “izotermike”, “të ftohtë”, “frigoriferike” ose “kaloriferike”.

5.1 Kontrollat, në përputhje me standardet e ATP, duhet të bëhen (paragrafit 1, shtojca 1, aneksi 1 i marrëveshjes):

- a) para se pajisja të vihet në punë;
- b) periodikisht, të paktën një herë në 6 vjet;
- c) kur kërkohej nga autoriteti kompetent çdo 3 vjet.

5.1.1 Përveçse në rastet e parashikuara në seksionet 5 dhe 6 të shtojcës 2 të aneksit 1 të marrëveshjes, kontrollat kryhen nga një qendër testuese e projektuar apo e miratuar nga autoriteti përgjegjës i vendit ku është regjistruar mjeti i transportit, me përjashtim kur për shkronjën “a” të pikës 5.1 më sipër, është kryer kontroll mbi mjetin ose në një prototip të tij në një qendër testuese të





projektuar apo miratuar nga autoriteti përgjegjës i shtetit në të cilin mjete i transportit është prodhuar.

6. Klasifikimi i mjeteve të transportit ndërkombëtar për qëllim të kryerjes së kontrolleve sipas pikës 5.1 të këtij udhëzimi, bëhet në dy grupe:

6.1 Grupi I: Mjetet e transportit të pajisura me karroceri izotermike, me ose pa grup frigoriferi, që u janë nënshtruar paraprakisht provave nga konstruktori i kasës izotermike, ose që bëjnë pjesë në një seri, për të cilën është lëshuar një raport prove nga një qendër e autorizuar në një nga palët kontraktuese të marrëveshjes ATP. Këtu përfshihen rastet e mjeteve:

- a) të regjistruara në Shqipëri;
- b) të reja që regjistrohen për herë të parë në Shqipëri;
- c) të transferuara nga një shtet tjetër palë kontraktuese e ATP.

6.2 Grupi II: Mjetet e transportit të pajisura me karroceri izotermike, me ose pa grup frigoriferi, që nuk u janë nënshtruar asnjëherë provave për verifikimin e aftësisë për të kryer këtë lloj transporti.

#### 7. Certifikata e miratimit ATP

Autoriteti kompetent (DPSHTRR) për të gjitha mjetet e transportit të regjistruara në Shqipëri, lëshon për transportin ndërkombëtar certifikatën e përputhjes me standardet ATP sipas modelit të lidhjes 1 të këtij udhëzimi (shtojca 3, aneksi 1 i marrëveshjes).

7.1 Dokumentacioni dhe kontrollet për t'u pajisur me certifikatën e miratimit ATP, për mjetet sipas përcaktimit në grupin I (shkronja "a" e pikës 6.1 të këtij udhëzimi).

Autoriteti kompetent lëshon për mjetin e transportit certifikatën ATP, pasi paraqitet dokumentacioni:

a) certifikatë homologimi e karrocerisë/kasës izotermike, lëshuar nga konstruktori, nga e cila duhet të rezultojnë: marka, tipi, seria, dimensionet e jashtme në metra, dimensionet e brendshme në metra, trashësia e mureve, vlera e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë k;

b) certifikatë homologimi e grupit frigorifer/kalorifer (nëse nevojitet), lëshuar nga konstruktori, në të cilën të rezultojnë: marka, tipi dhe numri i serisë, kapaciteti W, të dhëna në 0°C, -10°C dhe -20°C;

si dhe pasi kryhen kontrollet:

c) kontrolli i dimensioneve të kasës, numrit të saj të identifikimit dhe eventualisht të grupit frigorifer/kalorifer dhe praninë e etiketës së identifikimit.

ç) verifikimi i kapacitetit të grupit frigorifer/kalorifer të instaluar W, nëse është i përshtatshëm me arritjen e klasës, duke aplikuar formulat dhe procedurat sipas shtojcës 2, aneksi 1, ku W është kapaciteti termik i kërkuar, i nevojshëm për të ruajtur diferencën absolute  $\Delta t$  midis temperaturës mesatare të brendshme  $T_i$  dhe temperaturës mesatare të jashtme  $T_e$ , për një trup me sipërfaqe mesatare S.

d) kryhen mbi kasën verifikimet e përmendura në seksionin 5 të shtojcës 2, aneksi 1 i ATP-së. Pas këtyre verifikimeve, përpilohet një raport/procesverbal sipas modelit përkatës të miratuar nga marrëveshja ATP në shtojcën 2, aneksi 1;

e) nëse mjete i transportit është i pajisur edhe me grupin frigorifer ose kalorifer, kryhen provat e përmendura në seksionin 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të ATP-së.

Pas këtyre verifikimeve, përpilohet një procesverbal sipas modelit përkatës të miratuar nga marrëveshja ATP.

f) kontrolli nëse mbi mjetin e transportit janë të vendosura shenjat dalluese dhe treguese, sipas dispozitave të pikës 10.2 dhe 10.3 të këtij udhëzimi (shtojca 4, aneksi 1 i marrëveshjes).

7.1.1 Verifikimet dhe kontrollet sipas shkronjave "c", "ç", "d" dhe "e" më sipër, kryhen nga një ekspert ATP i emëruar, i cili kryen këto kontrolle sipas dispozitave të seksioneve 5 dhe 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes.

7.2 Dokumentacioni për lëshimin e certifikatës ATP për mjetet e transportit të reja, të regjistruara për herë të parë në Shqipëri, grupi I (shkronja “b” e pikës 6.1 të këtij udhëzimi):

a) nëse mjete të transportit është izotermik, pa grup frigoriferik ose kaloriferik, me dokumentin e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 7.1;

b) nëse mjete të transportit është i pajisur me grupin frigorifer/kalorifer, nevojitet paraqitja e dokumentacionit të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, pika 7.1, në këtë rast, nëse mjete të transportit është i pajisur me shenjat dalluese sipas pikës 10.2, duke treguar klasën që i përket, autoriteti përgjegjës lëshon certifikatën ATP pa ushtruar kontrolle të mëtejshme.

7.3 Për mjetet e transferuara nga një shtet palë kontraktuese e marrëveshjes ATP sipas përcaktimit në grupin I (shkronja “c” e pikës 6.1 të këtij udhëzimi), zbatohen tërësisht dispozitat e parashikuara në paragrafin 3, shtojca 1, aneksi 1 i marrëveshjes ATP. Certifikata lëshohet pas paraqitjes së dokumenteve:

a) raporti i provës i vetë pajisjes ose në rastet e pajisjes së prodhuar në seri, të pajisjes për një nga zgjedhjet e këtij grupi serie, e cila konsiderohet si certifikatë e miratimit të tipit.

Në rastin e një mjete të transportit (pajisjes) të prodhuar në seri, duhet të ketë specifikimet teknike të mjetit të transportit për të cilin duhet lëshuar certifikata, me të cilin pajisjet nga konstruktori i mjetit ose përfaqësuesi i tij ligjor i akredituar. Këto specifikime duhet të mbartin të gjitha elementet e raportit të testit në një nga tri gjuhët zyrtare të marrëveshjes);

b) certifikata ATP e lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit prodhues ose, për pajisjet në shërbim, nga autoriteti kompetent i shtetit në të cilin është i regjistruar. Kjo certifikatë do të trajtohet nga DPSHTRR, si një certifikatë provizore e vlefshme, për tre muaj;

7.3.1 Në rastin e mjetit transportues së transferuar pasi ka qenë në përdorim, mjete do të jetë subjekt i një inspektimi vizual për të konfirmuar përkatësinë e tij përpara se autoriteti kompetent të lëshojë certifikatën, kur mjete do të regjistrohet në Shqipëri.

7.4 Mjete të transportit të pajisura me karroceri izotermike, me ose pa grup frigoriferik, që qarkullojnë në Shqipëri, por që nuk u janë nënshtruar asnjëherë provave, grupi II (pika 6.2 e udhëzimit).

Marrëveshja ATP nuk parashikon aktualisht asnjë periudhë transitore për qarkullimin përmes territoreve të shteteve të mjeteve të transportit, të regjistruara në palët kontraktuese të marrëveshjes ATP. Me qëllim kontrollin e përputhjes me standardet e marrëveshjes ATP, kërkohet një kontroll i karakteristikave të izoluesit, instalimit të grupit ngrirës etj., ashtu siç përcaktohet në nënseksionin 5.1 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes ATP.

7.4.1 Për mjetet e përdorura të transportit, tashmë në qarkullim, kryhen provat e parashikuara në seksionin 5 (në veçanti nënseksioni 5.3) dhe seksionin 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes. Për lëshimin e certifikatës së konformitetit, ATP-ja kryhen provat dhe verifikimet vijuese nga ekspertët e emëruar:

a) kontrolli i izotermisë së mjetit (seksioni 5 i shtojcës 2, aneksi 1);

b) kontrolli i efikasitetit të pajisjeve termike (seksioni 6 i shtojcës 2, aneksi 1);

c) përcaktimi teorik i koeficientit të transmetimit të nxehtësisë  $k$  duke pasur parasysh formulat për transmetimin e nxehtësisë, duke përllogaritur një rënie vjetore 2% të vlerës së llogaritur.

Në përfundim të këtyre kontrolleve do të lëshohet një procesverbal prove, duke përdorur modelet 3, 7, 8, 9 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes.

7.4.2 Në vijim të prezantimit të procesverbaleve të lartpërmendura dhe të relacionit të vlerësimit të koeficientit  $k$ , autoriteti kompetent lëshon një certifikatë konformiteti sipas modelit ATP, që ka një vlefshmëri maksimale 3 vjet.

Në certifikatën ATP të konformitetit sipas lidhjes 1 të këtij udhëzimi, duhet shënuar lëshimi i saj pas kontrollit periodik (pika 7.1.3 në certifikatë) duke shënuar në vijim “kontrolli i jashtëzakonshëm” (shkronja c, paragrafi 1 i shtojcës 1, aneksi 1).



Në pikën 7.2.2 të certifikatës ATP, duhet shënuar “kontrolli i izotermisë dhe efienca e pajisjes termike”.

8. Certifikata ATP për transportin brenda vendit.

8.1 Për mjetet e transportit brenda vendit, të pajisura me karroceri izotermike, me ose pa grup frigoriferi, kryhen kontrollet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 7.4.1 të këtij udhëzimi.

8.2 Certifikata ATP për transport brenda vendit lëshohet pas 6 vjetësh nga regjistrimi i pare i mjetit dhe ka vlefshmëri maksimale prej 3 vjetësh. Modeli i certifikatës jepet në lidhjen 2 të këtij udhëzimi.

8.3 Kërkesa për t’u pajisur me certifikatë ATP për transport brenda vendit shoqërohet me dokumentet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” (në përsëritjen e certifikatës) të pikës 9.3 të këtij udhëzimi.

9. Vlefshmëria dhe kërkesat për lëshimin e certifikatës ATP

9.1 Certifikata ATP e lëshuar për herë të parë (për mjetet e reja) ka vlefshmëri prej 6 vjetësh, e cila lëshohet mbi bazë të procedurave të pikës 7.2 të udhëzimit.

9.2 Pas 6 vjetësh të para certifikata ATP lëshohet për tre vjet të tjera. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin:

a) certifikata origjinale ATP së cilës i ka përfunduar afati, në rast humbje/vjedhje akti i denoncimit dhe një kopje e saj;

b) kopje e lejes së qarkullimit;

9.3 Pas 9 vjetësh certifikata ATP lëshohet vetëm pas një prove apo kontrolli nga eksperti dhe kanë, në çdo rast, një vlefshmëri maksimale prej 3 vjetësh.

Kërkesa për t’u pajisur me certifikatë shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) procesverbali origjinal i ekspertit; ose

procesverbali/raporti i testimi i kryer nga ekspertët e emëruar në palët kontraktuese të marrëveshjes ATP, në ambientet e provës të njohura zyrtarisht nga autoritetet kompetente të këtyre shteteve.

b) dokumentet e mjetit të transportit dhe pajisjes që të rezultojë që të jenë në përputhje me mjetin e transportit dhe grupin frigorifer/kalorifer.

c) kopje e noterizuar/origjinale e certifikatës së mëparshme nëse është ende e vlefshme, ose certifikata e mëparshme e skaduar, e vlefshme në origjinal ose kur certifikata nuk është e disponueshme: kopje e denoncimit të kryer për humbjen e saj, vjedhjen, ose deklarimi i një zyre përgjegjëse të DPSHTRR që mjetit të transportit i është lëshuar një certifikatë ATP.

9.3.1 Pasi kontrollohet procesverbali i ekspertit, përgjegjësi i zyrës përkatëse për lëshimin e certifikatës ATP, firmos tri kopjet e certifikatës; një kopje origjinale, me vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve për pagesën i lëshohet pronarit të mjetit (të interesuarit) një kopje mbetet në praktikë dhe kopja e tretë arkivohet sipas numrit të targës (etiketës), në rast se humbet dhe/ose dëmtohet.

9.3.2 Nëse mjeti kontrollohet brenda gjashtë muajve nga data e skadencës (mbarimit të afatit), mund t’i lëshohet një certifikatë e vlefshme për një maksimum 3-vjeçar nga data e skadencës së certifikatës së mëparshme.

9.4 Prezantimi i praktikës pranë zyrave përkatëse të autoritetit kompetent për t’u pajisur me certifikatën ATP bëhet nga pronari i mjetit ose personi i autorizuar prej tij.

10. Shenjat dalluese që duhet të vendosen në mjetin transportues.

10.1 Certifikata ATP ose një kopje e origjinalit të saj, duhet të mbahet gjatë transportit dhe të paraqitet kur kërkohet nga autoritetet e kontrollit. Nëse në mjet është fiksuar pllaka e dëshmisë së përputhjes me standardet sipas shtojcës 3 (B) të aneksit 1, pllaka e përmendur duhet të njihet si ekuivalente e certifikatës ATP.

Pllaka e dëshmisë e sipërpërmendur duhet të hiqet menjëherë kur gjatë kontrollit konstatohet se mjeti nuk është më në përputhje me standardet e paraqitura në aneksin 1.

10.2 Trupat e pajisjeve izoluese transportuese dhe pajisjet ndihmëse të tyre, duhet të mbajnë në mënyrë të fiksuar, shenja dalluese nga prodhuesi, e cila të përfshijë të paktën këto veçanti si më poshtë:


- a) vendin e prodhimit apo shkronjat e përdorura në trafikun rrugor ndërkombëtar;
- b) emrin e prodhuesit apo kompanisë;
- c) modeli (numrat dhe/ose shkronjat);
- ç) numri i serisë;
- d) muaji dhe viti i prodhimit.

10.3 Shenjat dalluese dhe të veçanta duhet t'i bashkëngjiten pajisjes në përputhje me parashikimet e shtojcës 4 të aneksit 1. Ato duhet të hiqen menjëherë sapo pajisja të mos punojë më në përputhje me standardet e dhëna në këtë aneks. Këto shenja do të jenë me shkronja latine në blu të errët dhe në sfond të bardhë. Lartësia e shkronjave do të jetë të paktën 100 mm për shenjat e klasifikimit dhe jo më pak se 50 mm për datën e mbarimit të afatit të vlefshmërisë. Për pajisjet speciale, si një mjet i ngarkuar me një maksimum peshe, që nuk i kalon 3.5 tonë, lartësia e shenjave të klasifikimit mund të jetë 50 mm dhe të paktën deri në 25 mm për datën.

Shenjat ngjithëse tregojnë klasifikimin ATP të nxjerrë për atë mjet, muajin dhe vitin e skadencës.

Shenjat e klasifikimit dhe të datës së skadimit duhet të fiksohen në të dy këndet e sipërme të pjesës së përparme të mjetit.

Modeli i një shenje dalluese:



FRC - tregon pajisje frigoriferike e klasës C me izolim të thellë.

09-2012 – tregon afatin e mbarimit të certifikatës ATP (muaji shtator viti 2012), e cila përputhet me afatin e plotësuar në pikën 8, të certifikatës ATP (lidhja 1).

#### 11. Ekspertët ATP

11.1 Çdo ekspert ATP mund të kryejë veprimtarinë e tij në bazë të këtij udhëzimi dhe marrëveshjes, vetëm pranë ambientit të provave të miratuar nga autoriteti kompetent.

11.2 Dokumentet për ekspert ATP për kalimin në provën e aftësisë, të lëshuar nga një shtet palë kontraktuese e marrëveshjes, njihen për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në një ambient prove të vendosur në Shqipëri.

11.3 Kërkesat e pranimit në provën e aftësisë për ekspert.

11.3.1 Kandidati për ekspert duhet të tregojë se është i aftë për të kryer:

- a) operacione teknike të parashikuara në nënseksionet 5.1 dhe nga 6.1 deri 6.5 të shtojcës 2, aneksi 1;
- b) operacione administrative të parashikuara në seksionin 7 të shtojcës 2, aneksi 1;
- c) përllogaritjen teorike të koeficientit të transmetimit termik k;
- ç) përllogaritjen e aftësisë së pajisjes termike.

11.3.2 Kandidatët për t'u pranuar në provën e vlerësimit të aftësisë së ekspertit duhet të jenë në zotërim të kërkesave sipas lidhjes 3 të këtij udhëzimi.

11.4 Kandidati për ekspert duhet t'i nënshtrohet provës së aftësisë, e cila konsiston në një testim gojor për vërtetimin e njohurive të programit sipas lidhjes 4 të këtij udhëzimi dhe të aftësive praktike të nevojshme.



Komisioni për provën e aftësisë për ekspert kur e shikon të nevojshme mund t'i kërkojë kandidatit për ekspert të bëjë verifikimin e karakteristikave izotermike të një mjeti.

11.5 Inxhinierët me tituj sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 të lidhjes 3 të këtij udhëzimi, përjashtohen nga provat për pjesët I, II dhe III të programit të përshkruar në lidhjen 4 të këtij udhëzimi.

11.6 Kërkesa dhe dokumentacioni për pranim në provën e vlerësimit të aftësisë për ekspert dërgohet me postë pranë autoritetit kompetent. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përmes njoftimit në faqen zyrtare të saj të internetit përcakton datën, orën dhe vendndodhjen ku do të zhvillohen provat. Ky publikim do të ketë vlerën e një njoftimi me të gjitha kushtet e pranimit të kandidatit për ekspert.

11.7 Në përfundim të çdo prove vlefshmërie, do të afishohet në faqen zyrtare të internetit të DPSHTRR-së, lista e kandidatëve që kanë kryer provën, duke dhënë gjithashtu edhe rezultatet e përfituara. Ekspertët i nënshtrohen provës së aftësisë për ekspert një herë në dy vjet.

## 12. Komisioni për vlerësimin e ekspertit

Për vlerësimin e aftësisë së kandidatëve për ekspert ATP-je krijohet komisioni i cili përbëhet nga 3 veta dhe drejtohet nga Drejtori i Politikave të Transportit. Procedura dhe funksionimi i këtij komisioni përcaktohet me urdhër të ministrit.

## 13. Emërimi i ekspertëve

Emërimi si ekspert ATP për kryerjen e kontrolleve sipas seksioneve 5 dhe 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes ATP bëhet nga ministria, me kërkesë të protokolluar, të interesuarit, pasi është kryer verifikimi:

a) kalimi i provës së aftësisë si ekspert sipas pikës 11.7 ose dokumenti sipas pikës 11.2 të këtij udhëzimi;

b) të ketë në dispozicion një ambient për kryerjen e provave të autorizuara sipas pikës 14.1; ose një ambient për kryerjen e provave që plotëson kërkesat sipas pikës 14.2 dhe 14.3 të këtij udhëzimi; ose kontratë me pronarin e ambientit për kryerjen e provave të autorizuara ku të jetë shprehur qartë se eksperti autorizohet të kryejë veprimtarinë si ekspert në të;

c) deklarata se është në zotërim të dëshmimeve teknike dhe administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për llojin e veprimtarisë dhe kryerjen e provave.

## 14. Ambienti i kryerjes së provave

14.1 Autoriteti kompetent (DPSHTRR) miraton ambientin e kryerjes së provave, ose inspektimeve të autorizuara prej tij nga ekspertët ATP.

14.2 Subjekti që mund të jetë person fizik ose juridik kur aplikon për marrjen e autorizimit të ambientit të provave pranë DPSHTRR-së, duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:

a) ambienti për kryerjen e provave nga ekspertët e miratuar duhet të plotësojë kërkesat sipas lidhjes 5 të këtij udhëzimi;

b) të ketë të paktën një ekspert të emëruar ATP-je të certifikuar në një vend anëtar të ATP-së ose një ekspert të emëruar sipas pikës 13 të këtij udhëzimi;

c) të ketë në përdorim një ambient ku do të kryhen provat, të vërtetuar me anë të një dokumenti pronësie;

ç) të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së;

d) të ketë vërtetim të akreditimit sipas normave europiane të serisë EN ISO/IEC 17025, për ambientin e kryerjes së provave të pajisur me instrumentet e përshtatshme për prova specifike.

14.3 Ambientet e provave të pajisura me instrumentet e përshtatshme për kryerjen e provave i nënshtrohen një kontrolli fillestar nga një komision inspektimi i përbërë nga dy punonjës të DPSHTRR-së të caktuar për inspektimin dhe lëshimin e certifikatës ATP.

14.4 Autorizimi për ambientin e kryerjes së provave lëshohet me afat 3-vjeçar. Modeli i autorizimit është sipas lidhjes 6.

#### 15. Veprimtaria e ekspertëve ATP

15.1 Ekspertët e miratuar kryejnë vetëm kontrollet e përcaktuara në paragrafët 5 dhe 6 të shtojcës 2 të aneksit 1 të ATP.

15.2 Ekspertët zbatojnë dispozitat mbi metodat dhe procedurat për matjen dhe kontrollin e kapacitetit termik dhe efikasitetin e pajisjeve ftohëse ose ngrohëse për transportin e ushqimeve të përcaktuara në shtojcën 2 të aneksit 1 të marrëveshjes ATP.

15.3 Përpara fillimit të kontrollit, eksperti duhet të verifikojë paraprakisht të dhënat lidhur me identifikimin e mjetit të transportit ATP:

- a) targa e mjetit;
- b) numri i shasisë;
- c) targa e rimorkios;
- ç) targa e grupit të frigoriferit (nëse kërkohet);
- d) verifikimi në lejen e qarkullimit dhe në certifikatën e mëparshme të të dhënave të lartpërmendura: të kontrollojë të dhënat kundrejt atyre në mjetin e transportit.

Në rastin kur certifikata nuk është e disponueshme, është e nevojshme të kërkohet:

- a) kopje e denoncimit të kryer për humbjen e saj, vjedhjen, ose tjetër;
- b) deklarimi i zyrës kompetente të lëshimit të certifikatës, e cila të përmbajë të gjitha të dhënat teknike të certifikatës së mëparshme.

c) kopja e thjeshtë e procesverbalit të mëparshëm të ekspertit ATP ose të ambientit të provës;

Në rastin kur një ose më shumë nga të dhënat më sipër nuk korrespondojnë, eksperti procedon me kryerjen e provës duke evidentuar në procesverbal mangësitë e vërejtura, si dhe ta pasqyrojë në shkresën e përcjelljes së procesverbaleve.

15.4 Çdo tre muaj ekspertët i komunikojnë autoritetit kompetent listën e procesverbaleve të provave të kryera prej tyre.

#### 15.5 Etiketa

Për çdo mjet transporti që i nënshtrohet provës me rezultat të rregullt, lëshohet një etiketë nën kujdesin e ekspertit, e cila vendoset me anë të ngjitjes ose përmes një ribatine në pjesën e djathtë anësore të përparme, në pjesën e poshtme të trupit të mjetit të transportit, ose në afërsi të pjesës së poshtme të cisternave.

Etiketa i shtohet asaj origjinale dhe nuk i zëvendëson ato. Etiketa duhet të ketë dimensione minimale 120x60 mm, duhet të jetë në material alumini ose çeliku dhe duhet të mbartë të shtypur në mënyrë të pashkatërrueshme të dhënat vijuese me shkronja të larta minimumi 4 mm:

Eksperti A.T.P.:.....(emër, mbiemër);

Sigla A.T.P.:.....(FNA-IN-FRC-COIN etj.);

Nr. identifikues, prodhuesi dhe viti i prodhimit i pajisjes izotermike;

Data e vendosjes së etiketës:...(dita, muaji, viti).

Të dhënat përkatëse të numrit të identifikimit, prodhuesit, vitit të prodhimit nxirren nga certifikata ATP e skaduar ose në prag të skadencës dhe të etiketave të mëparshme ose nga markimi që i është bërë nga ndërtuesi i mjetit izotermik, siç parashikohet në pikën 10.2 të udhëzimit ose paragrafi 5 i shtojcës 1 të aneksit 1 i Marrëveshjes.

Vendosja e etiketës duhet kontrolluar nga autoriteti kompetent gjatë kontrollit të mjetit. Në rast humbjeje të etiketës, pas paraqitjes së një denoncimi të rregullt, përdoruesi duhet të paraqesë një kopje të procesverbalit të provës së ekspertit ose të kërkojë një dublikatë të së njëjtës etiketë ekspertit që ka kryer provën.

Mbi grupet frigoriferike nuk vendosen etiketa të posaçme të ekspertit.

#### 15.6 Prova me rezultat negativ



15.6.1 Në rastin kur prova nuk kalohet, eksperti duhet të hartojë një procesverbal me rezultat negativ dhe duhet për këtë të njoftojë zyrën përkatëse të DPSHTRR-së, aty ku e ka vendndodhjen pronari.

15.6.2 Në rastin kur prova nuk kalohet për pamjaftueshmëri të korrigjueshme të sistemit të ftohjes, mjeti i transportit mund t'i paraqitet ekspertit, brenda 30 ditëve nga prova negative, përmes një kërkesë tjetër prenotimi të motivueshme. Në procesverbalin e provës së re duhet të paraqiten, në rast rezultati pozitiv, ndërhyrjet e kryera.

15.6.3 Në rast rezultati negativ të provave të lartpërmendura, mjeti duhet t'i nënshtrohet kontrollit dhe provës ATP dhe deklarohet si mjet për transport mallrash dhe vendoset shënimi "mjet jo në përputhje me standardet ATP".

15.6.4 Në rastin kur mjeti rezulton i përshtatshëm me normat për një klasifikim ATP më të ulët sesa ajo origjinale, eksperti autorizohet të lëshojë procesverbalet me rezultat pozitiv, duke treguar deklasimin e mjetit me këto kushte:

a) pronari i mjetit duhet të lëshojë një deklaratë autorizuese me shkrim të deklasimit kundrejt ekspertit, origjinali i kësaj deklarate i duhet bashkëngjitur procesverbaleve;

b) në procesverbalet e ekspertit duhet të vendoset, në fund, një frazë me këtë përmbajtje: "deklasim nga.....në ..... sipas udhëzimit .....";

c) në certifikatë, edhe duke lënë të paprekur vlerën e koeficientit K, duhet të vendoset shënimi "i deklasuar nga (sigla A.T.P e mjetit)".

Edhe kur pronari është dakord me shkrim për deklasimin, eksperti lëshon një procesverbal negativ, dhe të ndjekë procedurën e lartpërmendur.

15.7 Arkivi i ekspertit dhe i zyrës së DPSHTRR-së për sa u përket kopjeve të thjeshta të procesverbaleve duhet të ruhet për një periudhë minimale prej 7 vjetësh.

## 16. Inspektimi dhe monitorimi

16.1 Zbatimi dhe monitorimi i dispozitave të këtij udhëzimi dhe i marrëveshjes ATP bëhet nga drejtoritë, të cilat mbulojnë veprimtaritë e transportit rrugor në ministri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

16.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit, emrat e ekspertëve ATP të emëruar dhe ambientet e provave të miratuara.

16.3 Inspektimi dhe kontrolli i veprimtarisë së ekspertëve për kryerjen e kontrolleve sipas seksioneve 5 dhe 6 të shtojcës 2, aneksi 1 i marrëveshjes, si dhe mbi plotësimin e kushteve të vendosura në këtë udhëzim, si dhe në marrëveshjen ATP bëhet nga inspektorët e specializuar të DPSHTRR-së.

16.4 Inspektimi i veprimtarisë së ekspertëve në qendrat e miratuara të provave, si dhe plotësimi i kërkesave të ambientit të provave, sipas pikës 14 të këtij udhëzimi kryhet të paktën një herë në vit.

16.5 Për plotësimin e detyrimeve të këtij udhëzimi, inspektorët dhe specialistët e DPSHTRR-së për kryerjen e kontrolleve sipas pikave 16.3 dhe 16.4 më sipër, dhe ata të caktuar për lëshimin e certifikatës ATP, duhet të jenë të trajnuar nga institucione të akredituara.

16.6 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të ndërpresë në çdo moment veprimtarinë e ekspertit kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij udhëzimi dhe të marrëveshjes dhe të njoftojë për veprimin e ndërmarrë MPPT-në.

16.7 Zyrat përkatëse të caktuara nga autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatës ATP, përsëritjen e saj, janë përgjegjëse dhe për sa i përket mbikëqyrjes së veprimtarisë së ekspertit të miratuar dhe plotësimit të kushteve të ambientit për kryerjen e provave në zbatim të këtij udhëzimi.

16.8 Nëse zbulohen shkelje të marrëveshjes, kryer nga një person me qëndrim në territorin e njëjës prej palëve kontraktuese të marrëveshjes ATP, apo ushtrohet ndonjë masë ndëshkuese ndaj

tyre, autoriteti kompetent nëpërmjet MPPT-së duhet të njoftojë autoritetet kompetente të palës tjetër për shkeljen e ndodhur dhe masën ndëshkuese të vendosur.

17. Dispozita të përgjithshme

17.1 Certifikata e miratimit ATP për transportin brenda vendit, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi, do të lëshohet pas miratimit të ambienteve të provave me vendndodhje në Shqipëri.

17.2 DPSHTRR-ja duhet të marrë masa për trajnimin pranë institucioneve të akredituara të specialisteve të saj, të ngarkuar me detyrime në zbatim të këtij udhëzimi.


17.3 DPSHTRR-ja të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit tekstin në gjuhën shqipe të marrëveshjes për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe për mjetet e veçanta që përdoren për këtë transport (ATP), i ndryshuar së fundi më 2 janar 2011. Përkthimi dhe publikimi i marrëveshjes të kryhet periodikisht nga DPSHTRR-ja sa herë rishqyrtohen dhe ribotohen anekset e saj.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**

*Lidhja 1*

Modeli i certifikatës ATP për transport ndërkombëtar, formati A4 ngjyrë e bardhë



Logja e institucionit

A.T.P. n.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

MJETI I TRANSPORTIT  
(*Equipment*)

IZOTERMIK (insulated)	I FTOHTË ( <i>refrigerated</i> )	FRIGORIFERIK (mechanically refrigerated)	KALORIFERIK (heated)
--------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------------	-------------------------

CERTIFIKATË - *CERTIFICATE*<sup>2</sup>

ATP \_\_\_\_\_

Lëshuar në përputhje me Marrëveshjen mbi transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe pajisjet speciale, që përdoren për këtë transport (ATP).

*Issued pursuant to the Agreement on the International Carriage of Perishable Foodstuffs and on the Special Equipment to be Used for such Carriage (ATP).*

1. Autoriteti që lëshon certifikatën: Drejtoria e Përgjithshme e SHTRR-së.  
(*Issuing authority*)

2. Mjeti i transportit:<sup>3</sup> Kamion: Iveco Fiat Shasia \_\_\_\_\_  
(*Equipment*)

<sup>1</sup> Simboli i vendit që përdoret në qarkullimin rrugor ndërkombëtar.

<sup>2</sup> Modeli i certifikatës duhet të printohet në gjuhën e vendit që e lëshon certifikatën dhe në gjuhën angleze, franceze ose ruse; pika të ndryshme do të numërohen sipas modelit.

<sup>3</sup> Tregoni tipin (kamion, rimorkio, gjysmërimorkio, kontejner etj.); në rastin e mjetit të transportit me cisternë të destinuar për transportin e ushqimeve të lëngshme, do të shtohet fjala "cisterna".





3. Targa e mjetit rrugor: \_\_\_\_\_ Lëshuar nga: \_\_\_\_\_  
(Registration number) (allotted by: )
- Numri serial i pajisjes izoluese: xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx  
(Insulated box serial number)
4. Pronari ose përdoruesi: \_\_\_\_\_  
(Owner or operated by:)
5. Paraqitur nga: \_\_\_\_\_  
(Submitted by)
6. Është miratuar si: <sup>1</sup> **Frigorifer normal Klasa A = FNAX**  
(Is approved as)
- 6.1 Me një ose më shumë dispozitivë termikë:<sup>2</sup> Grup frigo .....  
(With one or more thermal appliances which is (are) V 175 N.xxxxxxxxxx)
- 6.1.1 i pavarur (independent)
- 6.1.2 jo i pavarur (not independent)
- 6.1.3 i heqshëm (removable)
- 6.1.4 jo i heqshëm (not removable)
7. Parimet bazë të lëshimit të certifikatës:  
(Basis of issue of certificate)
- 7.1 Kjo certifikatë është lëshuar në bazë të:<sup>3</sup>  
(This certificate is issued on the basis of)
- 7.1.1 Testit të pajisjes  
(Tests of the equipment)
- 7.1.2 Konformitetit me një kampion të pajisjes  
(Conformity with a reference item of equipment)
- 7.1.3 Kontrollit periodik **Eksperti A.T.P.**  
(A periodic inspection)
- 7.2 Specifiko/Specify:
- 7.2.1 Qendra e provës  
(The testing station)
- 7.2.2 Lloji i provës<sup>4</sup>  
The nature of the tests
- 7.2.3 Numri/at e procesverbalit të provës  
The number(s) of the report(s):
- 7.2.4 Vlera e koeficientit K 0.nn W/m<sup>2</sup>K  
The K coefficient
- 7.2.5 Vëllimi efektiv ngrirës<sup>5</sup> në një temperaturë të jashtme 30°C dhe temperaturë të brendshme:  
The effective refrigerating capacity at an outside temperature of 30 °C  
and an inside temperature of : ..... °C. \_\_\_\_ W  
\_\_\_\_ °C. \_\_\_\_ W  
\_\_\_\_ °C. \_\_\_\_ W
8. Kjo certifikatë është e vlefshme deri më: \_\_\_\_\_  
This certificate is valid until:
- 8.1 Me kusht që/Provided that:
- 8.1.1 trupi i izoluar dhe, aty ku është i zbatueshëm, atrecatura termike është ruajtur në kushte të mira/The insulated body and, where applicable, the thermal appliance is maintained in good condition; and

<sup>1</sup> Fusni një ose më shumë përshkrime të treguara në shtojcën 4, aneksi 1.

<sup>2</sup>Fshini pikat e përmendura të panevojshme.

<sup>3</sup> Fshini pikat e përmendura të panevojshme.

<sup>4</sup>P.sh.: matja e koeficientit të përgjithshëm të transmetimit nxehtësisë, përcaktimi i efektshmërisë së aparateve ftohës etj.

<sup>5</sup> Në rastin kur kapaciteti ftohës matet në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.2.7, shtojca 2, aneksi 1.

<sup>6</sup> Fushat me gri janë plotësuar vetëm si shembuj për plotësim.

8.1.2 nuk është bërë ndryshim materiali në atrecaturat termike  
*No material alteration is made to the thermal appliances*

9. Lëshuar në: \_\_\_\_\_


*Done by:*

10. Në/On: VVVV/MM/DD

Autoriteti përgjegjës/*The competent authority*

\_\_\_\_\_

Përgjegjësi për ATP/*Responsible for the ATP*  
(*Officer name*)



A.T.P. n
----------

*Lidhja 2*

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR  
Drejtoria Rajonale e \_\_\_\_\_

CERTIFIKATË PËR TRANSPORTIN BRENDA VENDIT ME MJETE NË REGJIM TË  
TEMPERATURAVE TË KONTROLLUARA

Udhëzim i Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit nr. \_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_

IZOTERMIK	I FTOHTË	FRIGORIFERIK	KALORIFERIK
-----------	----------	--------------	-------------

1. Lloji i mjetit të transportit<sup>1</sup> \_\_\_\_\_
2. Targa e mjetit rrugor: \_\_\_\_\_ ; nr.shasisë: \_\_\_\_\_
3. Është aprovuar si:<sup>2</sup> **Frigorifer Normal Klasa A = FNAX**
- 3.1 Me një ose më shumë dispozitivë termikë:<sup>5</sup>
  - 3.1.1 i pavarur;
  - 3.1.2 jo i pavarur;
  - 3.1.3 i heqshëm;
  - 3.1.4 jo i heqshëm.
4. Kjo certifikatë është lëshuar në bazë të:<sup>3</sup>
  - 4.1 Testit të provës në;
  - 4.2 Konformitetit me një kampion të pajisjes;
  - 4.3 Kontrollit periodik.
5. Karrocera:
  - 5.1 Tipi i prodhimit;
  - 5.2 Numri i homologimit;<sup>4</sup>
  - 5.3 Numri i procesverbalit të provës;
  - 5.4 Vlera e koeficientit K 0.nn W/m<sup>2</sup>K.
6. Grupi frigoriferik:
  - 6.1 Tipi i prodhimit;
  - 6.2 Numri i homologimit;<sup>4</sup>
  - 6.3 Numri i procesverbalit të provës;
  - 6.4 Vëllimi efektiv ngrirës<sup>5</sup> në një temperaturë të jashtme 30 °C dhe temperaturë të brendshme:

<sup>1</sup> Tregoni tipin (kamion, rimorkio, gjysmërimorkio, kontejner etj.); në rastin e mjetit të transportit me cisternë të destinuar për transportin e ushqimeve të lëngshme, do të shtohet fjala “cisterna”.

<sup>2</sup>Fusni një ose më shumë përshkrime të treguara në shtojcën 4, aneksi 1 të marrëveshjes A.T.P.

<sup>3</sup> Fshini pikat e përmendura të panevojshme.

<sup>4</sup> Kur zbatohet.

<sup>5</sup> Në rastin kur kapaciteti ftohës matet në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.2.7, shtojca 2, aneksi 1.



0 °C ----- W  
-10 °C ----- W  
-20 °C ----- W

7. Kjo certifikatë është e vlefshme deri më:

**DATA, MUAJI, VITI**

7.1 Me kusht që:

7.1.1 trupi i izoluar dhe aty ku është i zbatueshëm, atrecatura termike është ruajtur në kushte të mira;

7.1.2 nuk është bërë ndryshim material në atrecaturat termike.

8. Lëshuar në: \_\_\_\_\_

Autoriteti kompetent \_\_\_\_\_

*Lidhja 3*

### KËRKESAT PËR EKSPERTIN ATP (PIKA 11.3.2):

1. Kandidati për t'u pranuar në provën për vlerësimin e aftësisë për ekspert duhet të jetë në zotërim të kërkesave të mëposhtme:

a) të ketë një nga dokumentet e mëposhtme:

a1) diplomën e inxhinierisë pas kursit të studimeve të paktën 4 vjet, ose diplomën

korresponduese;

a2) diplomë master në inxhinieri mekanike ose termodinamike, ose diploma korresponduese;

a3) diplomë trevjeçare në inxhinieri;

a4) diplomë (dëftesë) të ekspertit teknik industrial mekanik ose termoteknik.

b) kualifikime për ushtrimin e profesionit;

c) të ketë kryer aktivitet drejtimi ose projektimi teknik pranë një ndërmarrjeje që operon në sektorin e ndërtimit ose përgatitjen (mirëmbajtjen) e pajisjeve me karroceri izotermike, në cilësinë e titullarit ose të ortakut ose të punësuar, për një periudhë jo më pak se tre vjet nëse është në zotërim të një prej titujve të shkronjave a1), a2) dhe a3), ose për pesë vjet nëse është në zotërim të dokumentit sipas shkronjës a4);

d) të mos jetë dhe të mos i jetë nënshtruar asnjëherë masave ndëshkuese që lidhen me shkelje në ushtrimin e profesionit apo masa të tjera ndaluese.

2. Kërkesat e përshkruara për paraqitjen e kërkesës së pranimit për provën e aftësisë për ekspert duhet të jenë me datë të afatit të vlefshmërisë.

3. Administrata mund të procedojë në çdo moment, për shkaqe të motivuara, përjashtimin e kandidatit nga prova e aftësisë për mungesë të plotësisimit të kërkesave të listuar më sipër.

LISTA E LËNDËVE TË PROGRAMIT (pika 11.4):

Pjesa I: Elementet e termodinamikës  
 Nxehtësia dhe temperatura; variacionet e temperaturës dhe matja e temperaturës  
 Shkallët: Celcius, Fahrenheit dhe Kelvin; tipat e termometrave dhe karakteristikat e tyre  
 Perturbacionet e një termometri (gabimi sistematik)  
 Ndjeshmëria. Gadishmeria. Konstantja e kohës së termometrit  
 Termometrat me termokopje  
 Kompensimi i termokopjes  
 Procedimi i matjes. Gabimet e matjes. Analiza e të dhënave  
 Kapaciteti termik, nxehtësia specifike  
 Nxehtësitë e fshehura të shkrirjes dhe të avullimit  
 Energjia e brendshme dhe entropia e elementeve të ngurta dhe të lëngshme  
 Parimi i dytë i termodinamikës  
 Konvertimi i nxehtësisë në punë  
 Koncepti i rendimentit termodinamik të një motori termik  
 Transformimet reversibel dhe ireversibel  
 Cikli i Carnot: teorema e Carnot dhe rendimenti i ciklit të Carnot  
 Përcaktimi i madhësisë së entropisë  
 Pjesa II. Transmetimi i nxehtësisë  
 Konduksioni termik  
 Elemente të përgjithshme mbi konduksionin  
 Modalitetet e matjes së transmetueshmerisë termike të materialeve  
 Izolantet termike  
 Konduksioni termik në regjim stacionar  
 Transmetimi i nxehtësisë përmes pareteve të sheshta  
 Konduksioni termik në kushte regjimi variabël  
 Konveksioni (nënkuptohet fenomeni i shkëmbimit të nxehtësisë ndërmjet një sipërfaqeje  
 solide dhe një fluidi në lëvizje kundrejt saj)  
 Elemente të përgjithshme mbi konveksionin. Koeficienti i konveksionit  
 Konveksioni i sforcuar  
 Konveksioni i sforcuar mbi lastra të sheshta  
 Konveksioni natyral  
 Konveksioni natyral mbi sipërfaqe të sheshta  
 Rrezatimi  
 Elemente të përgjithshme mbi rrezatimin  
 Reagimi i trupave kundrejt rrezatimeve mbi një sipërfaqe  
 Pjesa III. Elementet e termodinamikës së aplikuar  
 Ciklet e impianteve me motorë termikë  
 Ciklet inverse: cikli frigoriferik  
 Cikli i Carnot si cikël frigoriferi referimi  
 Cikli frigoriferik me kompresion me avull  
 Lëngjet ngrirëse  
 Pjesa IV. Karrocëria izotermike  
 Elemente të përgjithshëm mbi karrocëritë izotermike  
 Materialet dhe elementet e ndërtimit të karrocërive izotermike edhe në lidhje me përvojat e  
 përftuara personale



Pjesa V. Normat përkatëse për transportin e mallrave që prishen dhe të mjeteve speciale që duhen përdorur për këto transporte (A.T.P.)

Normativa ndërkombëtare: marrëveshje lidhur me transportet ndërkombëtare të produkteve që prishen dhe të mjeteve të veçanta që duhen përdorur për këto transporte (A.T.P.), realizuar në Gjenevë më 1 shtator 1970

Ligji nr. 9289, datë 7.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen “Për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mjetet e veçanta, që përdoren në këto transporte”

Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar

Udhëzimet përkatëse të lëshuar nga Ministria e Transporteve lidhur me transportimin e produkteve që prishen dhe të mjeteve speciale që duhen përdorur për këto transporte (A.T.P.)

*Lidhja 5*

#### KËRKESAT PËR AMBIENTIN E PROVËS (pika 14.2):

##### A) Dimensionet

1. Gjerësia jo më pak se 5 m;
2. Gjatësia jo më pak se 15 m;
3. Hyrja të ketë gjerësi dhe lartësi respektivisht jo më pak se 3.00 m dhe 4.5 m.

##### B) Kushtet termike

1. Në lokalin e provës duhet garantuar një temperaturë e brendshme mesatare jo më pak se +15 oC (verifikimi që lokali i provave respekton kushtin e lartpërmendur duhet kryer të paktën çdo 2 vjet).

##### C) Instrumentet

1. Metri.

2. Kalibri special për matjet e trashësisë së izolimit.

3. Dy instrumente për regjistrimin automatik, secili të paktën të 24 temperaturave, instrumenti duhet të jetë i programuar për intervalet e printimit si më poshtë vijojnë:

- më e vogël ose e barabartë me 15 min për mjetet frigoriferike;

- më e vogël ose e barabartë me 60 min për mjetet ngrirëse ose kaloriferike.

Instrumentet mund të jenë të aftë të regjistrojnë njëkohësisht edhe temperaturat e një ose më shumë automjeteve që i nënshtrohen provës.

Instrumentet duhet të mundësojnë printimin e të dy diagramëve të ndarë dhe të lexueshëm në vazhdimësi temperaturë-kohë për matjen e temperaturave mesatare të brendshme dhe të jashtme. Shkallët duhet të jenë lineare dhe duhet të mundësojnë vlerësimin e të dhënave më të rëndësishme (p.sh. ciklet që lidhen me funksionimin e termostatit).

4. Të paktën 48 sonda për matjen e temperaturës.

5. Termometër precizioni (+/- 0.2°C).

6. Impianti për eliminimin e gazit shkarkues për funksionimin e grupit frigorifer që tërhiqen nga motori i automjetit dhe sistemi i ftohjes i radiatorit/ose radiatorëve të automjetit.

7. Llamba me fuqi jo më pak se 150 W.

8. Instrumentet e përmendura në pikat e mësipërme u nënshtrohen një programi mirëmbajtje dhe kalibrimi të dokumentuar në një regjistër të posaçëm.

9. Arkivimi i aktiviteteve të kryera të jetë në dispozicion për dhjetë vitet e fundit.

Logoja e institucionit

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve  
të Transportit Rrugor

### AUTORIZIM PËR AMBIENTIN E KRYERJES SË PROVAVE

Shënime në lidhje me aplikimin, si dhe procesin e miratimit.

Mbajtësi i këtij autorizimi,

Emri i personit fizik ose juridik: \_\_\_\_\_

Me seli në: \_\_\_\_\_

Administrator/drejtor: \_\_\_\_\_

për miratimin në:

a) kryerjen e kontrollit të karakteristikave izotermike të mjeteve të transportit në regjim temperature të kontrolluar, sipas seksioneve 5 dhe 6 të shtojcës 2, aneksi 1 të marrëveshjes ATP, si dhe në rastet kur kërkohet nga autoriteti kompetent vepron në emër të tij për:

b) vlerësimin e përputhshmërisë së mjetit apo inspektime të tjera të kërkuara nga autoriteti kompetent;

është i autorizuar si ambient i kryerjes së provave nga ekspertët e emëruar, sipas kushteve të vendosura në ligjin nr. 9289, datë 7.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen mbi transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe për mjetet e veçanta që përdoren për këtë transport (ATP)” dhe udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ “Për kontrollin e mjeteve të transportit në regjim të temperaturave të kontrolluara sipas marrëveshjes ATP”.

Autorizimi është i vlefshëm nga \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_ deri më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_.

Firma dhe vula e autoritetit kompetent

### UDHËZIM

Nr. 102, datë 13.6. 2012

### PËR MËNYRËN E EVIDENTIMIT NË MUNGESË TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE, NË FUSHËN E QARKULLIMIT RRUGOR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 11 të pikës 1/a;b të nenit 12 dhe nenit 201 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, me qëllim që të ketë unifikim në evidentimin në mungesë të kundërvajtjeve në fushën e qarkullimit rrugor dhe njoftimin e tyre,

### UDHËZOJ:

I. Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor

1. Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor nga ana e shërbimeve të policisë rrugore të Policisë së Shtetit, të bëhet në këto raste:

a) pamundësia për të arritur një mjet, që lëviz me shpejtësi shumë të madhe;

b) kalim i një kryqëzimi me semafor, kur është ndezur drita e kuqe;



- c) parakalim në kthesë;
  - d) zbulimi i një shkeljeje nga një funksionar ose një agjent, në bordin e një mjete për transport publik;
  - e) zbulimi i shkeljes, me anë të mjeteve me pajisje të përshtatshme, që bëjnë të mundur përcaktimin e kundërvajtjes, më pas ose pasi mjete objekt është larguar nga vendi i kontrollit;
  - f) zbulimi i shkeljes në mungesë të shkelësit dhe të pronarit të mjetit.
2. Punonjësi i shërbimit të patrullës së përgjithshme me atributet e agjentit verifikues, evidenton në mungesë kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor vetëm në rastet e konstatimit të shkeljeve në mungesë të drejtuesit të mjetit, të parashikuara në nenet 155 dhe 156 të Kodit Rrugor, respektivisht:
- Ndalim qëndrimi dhe pushimi i mjeteve, parashikuar nga (neni 155, neni 156) i Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.
3. Punonjësit e shërbimit të patrullës së përgjithshme, në të gjitha rastet e shkeljeve të parashikuara në nenin 157 të Kodit Rrugor, që kanë të bëjnë me heqjen dhe bllokimin e mjeteve, të njoftojnë shërbimet e policisë rrugore për ushtrimin e kompetencave në bazë të Kodit Rrugor.
4. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të normave të qarkullimit në mungesë të drejtuesit të mjetit, punonjësi i policisë vepron si më poshtë:
- a) njofton menjëherë sallën e drejtimit, koordinimit të emergjencave sipas juridiksionit territorial, duke i raportuar këto të dhëna: tipin, targën e mjetit, vendndodhjen, shkeljen e konstatuar, duke specifikuar sinjalistikën rrugore ekzistuese, numrin e serisë së procesverbalit të konstatimit që do të plotësojë;
  - b) plotëson procesverbalin e konstatimit dhe një kopje e vendos në xhamin e mjetit.
5. Punonjësi i shërbimit të sallës së drejtimit, koordinimit të emergjencave të juridiksionit territorial dhe punonjësi i shërbimit të sallës së drejtimit, koordinimit të emergjencave të Njësisë së Policisë Rrugore Tiranë, në rastet kur marrin njoftim për konstatimet e shkeljeve të normave të qarkullimit rrugor në mungesë, vepron si më poshtë:
- a) plotëson menjëherë të dhënat e marra në regjistrin model 1, bashkëlidhur dhe pjesë integrale të këtij udhëzimi. Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë kronologjike për çdo rast të raportuar. Mosplotësimi në kohë dhe saktë i regjistrit përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës të fillojë ecuria disiplinore në bazë të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit;
  - b) të njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë që njofton shkeljen e konstatuar.
6. Punonjësi i policisë në përfundim të shërbimit i raporton dhe i dorëzon eprorit të drejtpërdrejtë ose atij të caktuar në këtë detyrë, origjinalin dhe kopjen e tretë të procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë për verifikim dhe evidentim të mëtejshëm.
7. Eprori i drejtpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë, bën kontrollin e saktësisë së plotësimit të procesverbalit dhe evidentimit të bërë në sallën e drejtimit, koordinimit të emergjencave.
- Eprori i drejtpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë është autoriteti i vetëm dhe përgjegjës për dorëzimin e dokumentuar respektivisht në financë dhe sektorin operacional, të procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve në mungesë të drejtuesit të mjetit.
- Dorëzimi sa më sipër nga eprori i drejtpërdrejtë ose ai i caktuar në këtë detyrë, i procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve në mungesë të drejtuesit të mjetit, duhet të bëhet sa më shpejt, por në asnjë rast, jo më vonë se 14 orë nga koha e pranimit për kontroll.
- Plotësimi me mangësi i procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë, apo mosdorëzimi sipas afateve të përcaktuara, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me akt të veçantë të përcaktojë procedurat që do të ndiqen në raste të tilla.

II. Njoftimi i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor të konstatuara në mungesë.

1. Njoftimi i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor të konstatuara në mungesë të bëhet si më poshtë:

a) nëpërmjet punonjësve të Policisë së Shtetit;

b) nëpërmjet shërbimit postar mbi bazën e aktmarrëveshjes së përbashkët ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Postës Shqiptare;

c) njoftimi konsiderohet i kryer me korrektësi kur konfirmohet se është bërë në adresën e dhënë për rezidencën ose vendbanimin e kundërvajtësit ose pronarit të mjetit;

d) dërgimi i njoftimit zyrtar dhe saktësia e adresës për njoftimin, bëhet nga struktura përkatëse policore ku është efektiv punonjësi i policisë që ka plotësuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes në mungesë, jo më vonë se 24 orë, nga koha e plotësimit të procesverbalit. Kur llogaritja e këtij afati qëllon në një ditë kur administrata është e mbyllur apo funksionon me orare të reduktuara, afati shtyhet për ditën pasardhëse të punës;

e) dokumenti i konfirmimit të njoftimit si më sipër, i administruar zyrtarisht nga struktura përkatëse policore, është pjesë përbërëse e procesverbalit të konstatimit të shkeljes në mungesë, për efekte të hedhjes në sistem dhe llogaritjes së afateve të shlyerjes së detyrimeve nga kundërvajtësi;

f) për çdo rast, kur njoftimi nuk është kryer brenda afatit prej 30 ditësh kalendarike nga konstatimi i shkeljes e për pasojë pagesa e gjobës së vendosur, nuk mund të kërkohet për arkëtim, të bëhet analizë e veçantë për përgjegjësit e masat përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me akt të veçantë të përcaktojë procedurat që do të ndiqen në raste të tilla.

III. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë efektivat e Policisë së Shtetit, institucioni i prefektit dhe kryetarët e bashkive që kanë kompetenca në këtë drejtim për zbatimin e Kodit Rrugor.

IV. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM**  
**Bujar Nishani**

Në mungesë dhe me porosi  
**Zëvendësministri, Avenir Peka**

**Model 1**

**REGJISTRI I PROCESVERBALEVE TË KONSTATIMIT TË SHKELJEVE NË MUNGESË**

Nr.	Data	Ora	Vendi i konstatimit të shkeljes	Pajisja me sinjalistikë	Lloji i shkeljes	Procesverbali i plotësuar			Agjenti verifikues	Specialisti i sallës së drejtim
						Nr i serisë	Targa e mjetit	Vlera (me shkrim)		





**UDHËZIM**  
**Nr. 106, datë 19.6.2012**

**PËR KONTROLLIN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE NGA SUBJEKTET QË KRYEJNË  
VEPRIMTARINË PËR MBLEDHJEN, DEPOZITIMIN DHE SHKATËRRIMIN E MJETEVE  
OSE TË PJESËVE TË TYRE, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenet 4, pika 1/b, dhe 7, pika 1/c, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të neneve 26/3 dhe 27/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, me qëllim kontrollin e zbatimit të rregullave nga subjektet që kryejnë këtë veprimtari në mjedise private e publike,

**UDHËZOJ:**

**KREU I**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që duhen zbatuar, si dhe të ushtrojë kompetencat që i jep ligji Policisë së Shtetit ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën e:

- a) mbledhjes, depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve, me motor dhe rimorkiot të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;
- b) ruajtjes së mjeteve në mjediset publike e private të ashtuquajtura parkime;
- c) vënies në dispozicion ndaj të tretëve dhe të dhënies me qira të automjeteve pa drejtues.

**Neni 2**

**Regjistrimi i subjekteve dhe ushtrimi i veprimtarisë së mbledhjes,  
depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve**

1. Mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të nxjerra jashtë përdorimit, vendosen në vende të veçanta të përcaktuara në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor sipas kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.

2. Subjektet lejohen të fillojnë veprimtarinë e mbledhjes, të depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve pasi të jenë regjistruar pranë DRSHT Rrugor, në territorin ku kanë selinë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Policisë së Qarkut) lëshon autorizimin për subjektin e regjistruar më parë për fillimin e aktivitetit sipas pikës 2 të këtij neni.

**Neni 3**

**Regjistri i hyrje-daljes**

1. Subjektet që kryejnë veprimtarinë e parashikuar në nenin 1, germa “a”, janë të detyruara të mbajnë një regjistër të veçantë për të gjitha hyrje-daljet, ku të shënojnë në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

- a) targën, numrin e shasisë së mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit ose të personit që e ka dorëzuar apo transportuar;
- b) të dhëna për karakteristika cilësore dhe sasiore të elementeve që mund të shfrytëzohen;

c) treguesit e pjesëve të rishfrytëzueshme që janë shitur, hedhur, si dhe gjeneralitetet e personit që ka bërë blerjen ose marrjen e tyre.

2. Regjistri i hyrje-daljeve mbahet dhe ruhet në mjediset ku kryhet grumbullimi, çmontimi, depozitimi ose copëtimi i mjeteve apo pjesëve të tyre.

## KREU II

### RUAJTJA E MJETEVE NË MJEDISËT PUBLIKE E PRIVATE DHE KRITERET E DHËNIES SË LEJEVE

#### Neni 4

#### **Ruajtja e mjeteve në mjedisë publike e private**

1. Ruajtja e mjeteve në mjedisë private a publike bëhet vetëm me lejen e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Policisë së Qarkut), në territorin e së cilës ndodhet mjedisi, në përputhje me dispozitat në fuqi “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, si dhe “Për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike”.

2. Në leje përshkruhen mjediset ku do të vendosen mjetet, numri i tyre maksimal, sistemet e mbrojtjes ndaj zjarrit, daljet e sigurisë dhe elementet e nevojshme për ruajtjen e sigurisë publike.

#### Neni 5

#### **Kushtet për dhënien e lejeve**

Subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë veprimtarinë sipas germës “b” të nenit 1 të këtij udhëzimi, që të pajisen me leje duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) kërkesë me shkrim nga titullari i subjektit për t’u pajisur me leje për veprimtarinë e ruajtjes së mjeteve në mjediset publike a private;
- b) në kërkesë të përcaktohen emri i subjektit, emri i administratorit, i përgjegjësit teknik;
- c) vërtetime për gjendjen gjyqësore nga organi i prokurorisë dhe i gjykatës.

#### Neni 6

#### **Dokumentet plotësuese për dhënien e lejes**

Përveç sa parashikohet në nenin 7, kërkesa me shkrim shoqërohet dhe me:

- a) kopje e noterizuar e licencës së lëshuar nga QKL-ja;
- b) vërtetim të lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;
- c) të plotësohen masat e sigurisë publike, si: rrethimi, ndriçimi, ndërlidhja, kushtet akomoduese për personelin e shërbimit, sipas procedurave standarde të përcaktuara në ligjin për shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

#### Neni 7

#### **Funksionimi i komisionit**

1. Në drejtoritë e policive në qarqe, në sektorin e rendit dhe sigurisë publike, funksionon komisioni për verifikimin e kushteve të përcaktuara më lart për çdo subjekt që ka paraqitur kërkesën me shkrim për marrjen e lejes.

2. Komisioni ngrihet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Qarkut dhe përbëhet nga:

- |                                                                          |          |
|--------------------------------------------------------------------------|----------|
| - shefi i sektorit të rendit dhe sigurisë publike                        | kryetar; |
| - një përfaqësues nga seksioni i SHRSF-së                                | anëtar;  |
| - një përfaqësues nga seksioni i Koordinimit dhe Parandalimit të Krimeve | anëtar.  |



3. Komisioni mblidhet jo më pak se një herë në muaj dhe pasi verifikon dokumentacionin, kushtet dhe kriteret e kërkuara në përputhje me ligjin nr. 9537, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, për subjektin që ka paraqitur kërkesën, shprehet me vendim.

4. Kundër vendimit të komisionit, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e vendimit çdo subjekt ka të drejtën e ankimit administrativ te Drejtori i Policisë së Qarkut, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

### KREU III

#### VËNIA NË DISPOZICION DHE DHËNIA ME QIRA E MJETEVE PA DREJTUES

##### Neni 8

#### **Vënia në dispozicion e mjeteve pa drejtues**

Personi juridik apo fizik, pas plotësimit të detyrimeve ligjore në fushën e tatim-taksave, është i detyruar të pajiset me leje nga Drejtoria e Policisë së Qarkut.

##### Neni 9

#### **Dhënia e lejes**

Për veprimtarinë e vënies në dispozicion dhe dhënies me qira të mjeteve pa drejtues, leja jepet nga komisioni sipas procedurave të parashikuara në nenin 9 të këtij udhëzimi.

##### Neni 10

#### **Regjistri i mjeteve**

Subjekti i pajisur me dokumentacionin përkatës për ushtrimin e kësaj veprimtarie është i detyruar të mbajë një regjister ku të shënojë në mënyrë të saktë dhe pa korrigjime:

- datën e marrjes në dorëzim dhe të ridorëzimit të mjetit të dhënë me qira;
- kopje të dokumentit të identifikimit të personit qiramarrës;
- këto të dhëna shënohen në momentin e kryerjes së veprimit të dhënies me qira të mjetit.

### KREU IV

#### DISPOZITAT PËR LËSHIMIN E LEJEVE

##### Neni 11

#### **Kompetenca për lëshimin e lejeve**

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtorja e Policisë së Qarkut) është autoriteti kompetent i ngarkuar me ligj për lëshimin e lejeve:

- a) për veprimtarinë e ruajtjes së mjeteve në mjedise private apo publike;
- b) për veprimtarinë e vënies në dispozicion dhe dhënies me qira të mjeteve pa drejtues;
- c) për veprimtarinë e mbledhjes, të depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve, me motor dhe rimorkiot të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

Neni 12

**Kufizimet për dhënien e lejes**

Leje dhe autorizim nuk u jepet personave:

1. Të dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë:

- për krime kundër rendit publik dhe kundër personit të kryera me dhunë, vjedhje me dhunë;  
- për rrëmbime personi për qëllim përfitimi, vjedhje të automjeteve ose trafik i mjeteve motorike; si dhe

- të dënuar në heqje lirie më shumë se tre vjet për krime për motive të dobëta.

2. Që nuk zotërojnë mjedise të përshtatshme pune dhe mundësi të mjaftueshme financiare të vlerësuara sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e transporteve nr. 9, datë 3.7.2007 “Për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes, ndërmjetësimit, të autoriparimit, për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot e tyre të autorizuar nga prodhuesi”.

Neni 13

**Leja e subjekteve juridike**

1. Për subjektet juridike, leja lëshohet në emër të shoqërisë sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Për subjektin juridik kërkesat e veçanta të formimit ose të aftësisë profesionale duhet të plotësohen të paktën prej njërit prej ortakëve.

Neni 14

**Përgjegjësia profesionale**

Titullari i subjektit juridik e fizik është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është marrë leja apo autorizimi, duke mbartur të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 15

**Vlefshmëria e lejeve**

Lejet e parashikuara në këtë udhëzim hyjnë në fuqi një ditë pas lëshimit të tyre dhe kanë vlefshmëri deri në pesë vjet, me të drejtë rinovimi.

Neni 16

**Revokimi i lejeve**

Lejet revokohen kur:

- a) dëmtojnë interesat e palëve të cilave u drejtohen;
- b) të gjitha palët e interesuara bien dakord për revokimin ose shfuqizimin e saj, me kusht që leja të ketë krijuar të drejta të tilla nga të cilat nuk mund të hiqet dorë;
- c) në çdo rast nga organi që i ka lëshuar ato, kur gjykohet që vazhdimi i veprimtarisë cenon parimet e sigurisë publike.

Neni 17

**E drejta e përfaqësimit**

Në të gjitha veprimtaritë e regjistruara lejohet e drejta e përfaqësimit, por për lejet e dhëna subjekteve fizike apo juridike, leja nuk mundet të jepet ose t’u transferohet me çfarëdo lloji titulli subjekteve të tjera.



## KREU V DISPOZITA PËR MBAJTJEN E REGJISTRAVE

### Neni 18 **Mbajtja e regjistrave**

1. Regjistrat e parashikuar në këtë udhëzim duhet të jenë në numërtuara, të vulosura në çdo faqe nga organet që e lëshojnë dhe të kompjuterizuara.
2. Regjistrat duhet të mbahen pastër, në gjendje të mirë dhe shënimet të bëhen në mënyrë kronologjike, pa fshirje, korrigjime ose heqje.
3. Në përfundim të veprimtarisë për të cilën është lëshuar leja apo autorizimi përkatës, regjistrat i kthehen autoritetit që i ka lëshuar ato.
4. Regjistrat u vihen në dispozicion autoriteteve të përcaktuara në këtë udhëzim sa herë që është e nevojshme për të kontrolluar shënimet e mbajtura.

## KREU VI SANKSIONET DHE USHTRIMI I KONTROLLIT

### Neni 19 **Mbikëqyrja dhe kontrolli**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Policisë së Qarkut) është autoriteti që ka të drejtën e kontrollit dhe zbatimit të këtij udhëzimi, për konstatimin e kundërvajtjeve administrative, si dhe vendosjen dhe mbledhjen e gjobave sipas procedurës përkatëse.
2. Punonjësit e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Drejtoria e Policisë së Qarkut) lejohen të hyjnë në mjediset ku ushtron veprimtarinë subjekti që është i pajisur me leje, për të kontrolluar lejen dhe të dhënat që mbahen në regjistrat përkatës.

### Neni 20 **Shkeljet administrative**

1. Ushtrimi i veprimtarisë të parashikuar në nenin 1 të këtij udhëzimi pa lejen përkatëse, si dhe shënimi i të dhënave fiktive, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, si më poshtë:
  - a) për subjektet, me objekt veprimtarie mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin e mjeteve ose pjesë të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.
  2. Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë shkeljet e mëposhtme:
    - a) mungesat ose parregullsitë në plotësimin e regjistrave të parashikuar nga ky udhëzim, si dhe përdorimi i regjistrave të pavulosur apo me fletë mangët;
    - b) kryerja e veprimeve me persona të pidentifikuar me letërnjoftim ose dokument tjetër identifikimi.

### Neni 21 **Shkelja e kushteve të lejes**

Kur titullari i njëres prej lejeve të parashikuara në këtë udhëzim shkel kushtet e përcaktuara, kryen kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Neni 22

**Shpërndarja e të ardhurave**

Të ardhurat nga gjobat i kalojnë në masën 60 për qind Buxhetit të Shtetit dhe 40 për qind organit që ka verifikuar shkeljen, për t'i përdorur sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Brendshëm, për përmirësimin e shërbimit, në zbatim të ligjit nr. 9537, datë 3.7.2006 "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", kurse 60 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

Neni 23

**Pushimi dhe pezullimi i veprimtarisë**

1. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që kryejnë kontrollin, kur vërejnë shkelje të kërkesave të ligjit dhe të udhëzimit, kanë detyrimin të paraqesin një raport me shkrim dhe të vënë në dijeni, pa vonesë, autoritetin që ka lëshuar lejen.

2. Ky autoritet, me të marrë raportin, nxjerr urdhër, ku shënon edhe arsyet e këtij veprimi, për pezullimin e veprimtarisë së kryer pa lejen përkatëse.

Urdhri duhet të zbatohet brenda pesë ditëve.

3. Autoriteti, që ka lëshuar lejen, kur vëren shmangien e subjektit nga kushtet e përcaktuara në ligj, urdhëron pezullimin e veprimtarisë për aq kohë sa nevojitet për t'i plotësuar këto kushte, por jo më pak se 24 orë dhe jo më shumë se tre muaj.

Me skadimin e këtij afati leja revokohet.

4. Urdhri për pezullimin e veprimtarisë revokohet kur i interesuari provon se i ka plotësuar kushtet.

5. Drejtori i Policisë në qark, për rrethana të veçanta, urgjente, ose kur rrezikohet siguria e personit, urdhëron menjëherë pezullimin e veprimtarisë së autorizuar.

Neni 24

**E drejta e ankimit administrativ dhe afati kohor**

1. Organi administrativ përkatës shqyrton ankimin administrativ dhe është i detyruar të marrë vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

2. Shqyrtimi i ankimit administrativ bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 25

**E drejta e ankimit në gjykatë**

Nëse organi administrativ përkatës nuk ka marrë vendim brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 27, për ankimin e bërë, pala e interesuar fiton të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sipas paragrafit të dytë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 26

**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Në mungesë dhe me porosi  
**Zëvendësministri, Avenir Peka**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.7.2012  
Doli nga shtypi më 5.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë